



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**  
**Nr. 6, Dt. 27.03.2008**

*Per miratim te lejes, per shfrytezim inertesh ne shtratin e Perroit te Koramit, ne nje mjedis teresisht shtrat perroi, me aluvione te akumuluarra prej vitesh, ne afersi te qytetit Himare (ne verilindje te tij), subjektit "V.M.M.S" sh.p.k, Himare.*

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "V.M.M.S" sh.p.k, Himare, konform formularit "E", pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose". Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

- 1-Te mos miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e Perroit te Koramit, ne nje mjedis teresisht shtrat perroi, ne afersi te qytetit Himare (ne verilindje te tij), Bashkia Himare, Qarku Vlore, subjektit "V.M.M.S" sh.p.k, Himare.
- 2- Shkak per mos miratim eshte, mos paraqitja e subjektit "V.M.M.S" sh.p.k, Himare, prane A.R.M-se Vlore, per aplikim per Lejes Mjedisore.
- 3- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 4- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**KRYETARI I K.B.U "VJOSE"**  
**Xhevair REXHEPI**

**PERGJEGJES I A.U.B-se "VJOSE"**

**Vezir METAJ**

